

## **URBANISM WATCH**

Urbanizmi i Prizrenit nën  
vëzhgim të përhershëm

30 dhjetor 2013, Prizren

Komunikatë #8

### **KOMUNIKATË PËR MEDIA INSTITUCIONET T’I MBROJNË OBJEKTET ME VLERA TË PRIZRENIT**

“EC Ma Ndryshe” në kuadër të projektit “Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm” ka shqyrtuar ecurinë e hetimeve në lidhje me djegien e shtëpisë së familjes Shehu në lagjen “Tabakhanë”. Gjatë këtyre javëve janë mbledhur informata nga institucionet e hetuesisë dhe të sigurisë, në bazë të cilave supozohet se zjarri ishte shkaktuar nga instalimi i vjetër i rrymës elektrike.

Procesverbali i Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë lidhur me këtë incident të zjarrit supozon se zjarri është shkaktuar nga rrjeti elektrik, dhe thekson pamundësinë për vërtetimin e shkaktarit për shkak të djegies dhe rrënimit të shtëpisë. Në këtë raport thuhet se në objekt ka banuar një familje 14 anëtarëshe.

Ndërsa raporti i hetuesve të Policisë së Kosovës nga Stacioni Policor në Prizren bën të ditur se anëtarët e kësaj familjeje kanë konfirmuar problemet e shpeshta me instalimin e dobët elektrik. Duke u bazuar edhe në raportin e DES-it njësi të hetimeve ka ardhur në përfundim se në rastin konkret nuk janë gjetur elemente të ndonjë veprë penale dhe me këtë konstatim është njoftuar Prokuroria Themelore e Prizrenit.

Zyrtarët e Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve Historike në Prizren kanë pohuar se e kanë marrë këtë raport dhe se e kanë dërguar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Ndërsa krerët e Këshillit për Trashëgimi Kulturor të Qendrës Historike të Prizrenit kanë thënë se nuk kanë pranuar asnjë raport, edhe pse me një reagim publik kishin kërkuar marrjen e masave urgjente për zbardhjen e rastit.

Bazuar në këto të gjetura EC Ma Ndryshe sërish shpreh keqardhjen për këtë humbje kulturore të Prizrenit dhe apelon tek institucionet përgjegjëse që të ndërmarrin veprime për parandalimin e rasteve të tilla në të ardhmen, veçanërisht në Qendrën Historike të Prizrenit.

Konsiderojmë se Komuna e Prizrenit, IMMH-ja, MKRS-ja dhe organet tjera duhet të shtojnë përpjekjet e tyre në drejtim të identifikimit të objekteve me vlera të Prizrenit dhe hapave konkretë për ruajtjen e tyre nga shkatërrimi i tërësishëm.

Gjithashtu përkrahim rekomandimin e dhënë nga Këshilli për Trashëgimi Kulturor të Qendrës Historike të Prizrenit që “të merren të gjitha masat preventive që shtëpia të mos rrënohet tërësisht, duke vazhduar me punimet për konservimin dhe rindërtimin e saj dhe kthimin në gjendjen e mëparshme”.

Ndërsa KTK-në e rekomandojmë që të ndërmerr nismën për diskutim të kësaj problematike me të gjithë hisedarët, në mënyrë që të gjendet mënyra për rindërtimin e kësaj shtëpie, por edhe për parandalimin e dëmtimit dhe shkatërrimit të vlerave tjera të trashëgimisë kulturore të Prizrenit.

Me nderime,

Valon Xhabali, Koordinator i Projektit

OJQ EC Ma Ndryshe

Rr. Saraçët, Nr. 5 – Prizren & Rr. Perandori Dioklician, Nr. 14, kati(V) - Prishtinë

[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)

+381 38 224 967 & +381 29 222 771

## URBANISM WATCH

Urbanizmi i Prizrenit nën

vëzhgim të përhershëm

përkrahët financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Kosovo Foundation for Open Society  
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo